



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHTETËRORE
(VETËM PËR SHKOLLAT ARTISTIKE)**

LËNDA:

HARMONI

Koordinatore: Majlinda Hala

VITI MËSIMOR 2011 – 2012

1. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Harmoni”, përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të harmonisë për shkollën e mesme artistike profesionale të sistemit 3 dhe 4-vjeçar.

Programi orientues për provimin me zgjedhje i “Harmonisë”, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2011-2012, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme artistike, dega “Muzikë”, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit e harmonisë të shkollave artistike që do të përgatisin maturantët për provimin e harmonisë, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore* që duhet të zotërojnë ata për të përballuar me sukses provimin e harmonisë, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar*, që duhet zbatuar me korrektësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të harmonisë, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Programi orientues i harmonisë synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë.

Programi orientues është strukturuar në bazë të disa rubrikave që janë:

1. Tematikat që përshkruajnë përmbajtjen e programit.
2. Përshkrimi i tematikës dhe objektivat.
3. Tabela e peshave.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të interesuara. Në mënyrë të veçantë, të bëhet kujdes nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të harmonisë si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Vëmendje të tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program, me përqindjet që zënë këto tema në testin e kontrollit për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e harmonisë të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Nxënësit duhet të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve muzikore dhe aftësive të përcaktuara në program. Për të arritur këtë, herë-herë ata duhet t’u rikthehen dhe çështjeve të ndryshme të cilat, nuk janë parashikuar në program, por që përmbajnë informacion bazë për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim.

Materiali burimor mbi të cilin duhet të punojnë nxënësit, janë leksionet që ata kanë marrë nga mësuesit e tyre apo të gjitha burimet që ata kanë përdorur gjatë viteve për shqyrtimin

e përmbajtjeve mësimore, të tilla si: leksione, tekste të ndryshme që kanë të bëjnë me harmoninë etj.

2. TEMATIKAT E PËRMBAJTJES SË PROGRAMIT

1. **Harmonizimi me tri funksionet kryesore**
2. **Harmonizimi duke përdorur sistemin e plotë funksional**
3. **Harmonizimi duke përdorur tingujt joakordikë**
4. **Harmonizimi duke përdorur shmangiet dhe modulacione në tonalitete të afërta**
5. **Veçoritë e harmonizimit në modet e muzikës popullore shqiptare.**

3. TEMATIKA

1. Harmonizimi me tri funksionet kryesore

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë njeh nxënësit me shkencën e harmonisë, i aftëson ata me njohjen, ndërtimin dhe harmonizimin në të tri funksionet kryesore përmes: *Kuintakordit kryesor dhe vendosjes së tij në formacionin koral 4 zanor; spostimit të kuintakordit; lidhjes së kuintakorreve kryesore; lidhjes harmonike dhe lidhjes melodike; tonalitetit dhe tri funksioneve kryesore; harmonizimit të melodisë; harmonizimit të basit; kapërcimit të tercave; kadencës dhe kuartseksakordit të kadencës; sekstakordit dhe funksioneve kryesore; kuartseksakordit kalues dhe ndihmës.*

OBJEKTIVAT

Nr	Tematika	Objektivat
1.	Harmonizimi me tri funksionet kryesore	<ul style="list-style-type: none"> - Të ndërtojnë mbi tri akordet kryesore: <ul style="list-style-type: none"> - T- tonikë, - S- subdominantë, - D- dominantë bashkë me përmbysjet e tyre dhe si lidhen ato me njëri-tjetrin. - Të përcaktojnë saktë në një bass ose melodi të dhënë këto tri funksione. - Të përcaktojnë funksionet në një melodi ose bass të dhënë. - Të analizojnë një vepër muzikore, e cila ka këto tri funksione.

2. Harmonizimi duke përdorur sistemin e plotë funksional

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë njih dhe aftëson nxënësit me harmonizimin duke përdorur sistemin e plotë funksional përmes njohjes, kuptimit dhe zbatimit në praktikë të: *Sistemit të plotë funksional i tonalitetit maxhor dhe minor (harmonik); kuintakordit dhe seksakordit të gradit të dytë; septakordit të gradit të dytë dhe përmbysjet e tij; kuintakordit të gradit të gjashtë; kadencës së ndërprerë; kuintakordit të gradit të tretë; kuintakordit dhe sekstakordit të gradit të shtatë; septakordit të dominantës dhe përmbysjet e tij; septakordit të gradit të shtatë dhe përmbysjet e tij; nonakordit të dominantës; dominantës me sekstë; tonalitetit minor natyral, kthesës frigjane; sekuencës tonale diatonike.*

Nr	Tematika	Objektivat
2.	Harmonizimi duke përdorur sistemin e plotë funksional	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin sistemin e plotë funksional,- II7, VI, III, VII, D9, minorin natyral, kthesën frigjane, sekuencat diatonike.- Të kuptojnë rolin e tyre gjatë harmonizimeve muzikore.- Të harmonizojnë ushtrime apo vepra muzikore, në të cilat gjejnë përdorim këto funksione: <i>II7, VI, III, VII, D9, minori natyral, kthesa frigjane, sekuencat diatonike.</i>- Të analizojnë ushtrime apo vepra muzikore, në të cilat gjejnë përdorim funksionet e mësipërme.

3. Harmonizimi duke përdorur tingujt joakordikë

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë vazhdon të njohë nxënësit me harmonizimin, duke përdorur tingujt joakordikë. Këta tinguj janë: Tingujt joakordikë kalues; tingujt joakordikë ndihmës; tingujt joakordikë përshpejtues; tingujt joakordikë vonues; tipet e marrëdhënieve tonale - sistemi kromatik.

Nr	Tematika	Objektivat
3.	Harmonizimi duke përdorur tingujt joakordikë	<ul style="list-style-type: none">- Të harmonizojnë duke përdorur tingujt joakordik kalues, ndihmës, përshpejtues, votues; sistemin kromatik dhe tipet e marrëdhënieve tonale.- Të përcaktojnë në një melodi ose vepër muzikore tingujt joakordikë.- Të përdorin sistemin e plotë kromatik, gjatë një harmonizimi.

4. Harmonizimi duke përdorur shmangiet dhe modulacione në tonalitete të afërta

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë vazhdon të njohë nxënësit me shmangiet dhe mënyrat e realizimit të tyre gjatë harmonizimit të një melodie të dhënë. Ato realizohen përmes njohjes dhe zbatimit korrekt të: *Dubël dominantës në kadencë dhe në brendësi të ndërtimit muzikor; sekuencave kromatike dhe mënyrës së realizimit të tyre; modulacionit dhe llojeve të tij; modulacionit në tonalitetet e afërta të grupit Subdominant (S); modulacionit në tonalitetet e afërta të grupit dominant (D).*

Nr	Tematika	Objektivat
4.	Harmonizimi duke përdorur shmangiet dhe modulacione në tonalitete të afërta	<ul style="list-style-type: none">- Të kuptojnë dhe të realizojnë gjatë një detyre të dhënë:<ul style="list-style-type: none">- shmangiet dhe mënyrat e realizimit të tyre në një ndërtim.- Dubël dominantën në kadencë dhe në brendësi të ndërtimit muzikor.- Sekuencat kromatike dhe mënyrën e realizimit të tyre.- Modulacionin dhe llojet e tij.- Modulacionin në tonalitetet e afërta të grupit Subdominant (S).- Modulacionin në tonalitetet e afërta të grupit dominant (D).

5. Veçoritë e harmonizimit në modet e muzikës popullore shqiptare

Përshkrimi i tematikës: Modet Dorian, Frigjan, Lidian, Eolian, Jonik, Miksolidian. Modet me sekondë të zmadhuar (kromatikë).

Nr	Tematika	Objektivat
5.	Veçoritë e harmonizimit në modet e muzikës popullore shqiptare	<ul style="list-style-type: none">- Të njohin modet kryesore të muzikës popullore shqiptare.- Të harmonizojnë, duke përdorur këto mode të muzikës popullore shqiptare.

4. TABELA E PESHËS SË TEMATIKAVE NË PËRQINDJE

Tematika	Përqindja
Harmonizimi me tri funksionet kryesore	50%
Harmonizimi duke përdorur sistemin e plotë funksional	25%
Harmonizimi duke përdorur tingujt joakordikë	10%
Harmonizimi duke përdorur shmangiet dhe modulacione në tonalitete të afërta	10 %
Veçoritë e harmonizimit në modet e muzikës popullore shqiptare	5 %
Gjithsej:	100 %